**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

3114 24
12 / 10/ 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 60, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

1. **SHAQIR HAXHIMUSTAFA** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtar i Shërbimeve Sociale në Qendrën për Punë Sociale, në Drejtorinë komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS,** nga data 10.10.2023.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Buxhet dhe Financa që punëtorin ta largojë nga lista e pagave, nga data 10.10.2023.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Punëtori **SHAQIR HAXHIMUSTAFA** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtar i Shërbimeve Sociale në Qendrën për Punë Sociale, në Drejtorinë komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS,** nga data 10.10.2023.

Sipas detyrës zyrtare, Njësia e personelit ka konstatuar se punëtori i lartpërmendur, më datë 9.10.2023, arrin moshën e pensionimit, ngase i bën 65 vjet.

Prandaj, kryetari i Komunës, pas administrimit të provave dhe të fakteve, vërtetoi gjendjen faktike dhe vendosi që punëtorit Shaqir Haxhimustafa, nga data 10.10.2023, **I PËRFUNDON** marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit.

Nga sa u tha më lart, kryetari i Komunës, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi, punëtori ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Këshillit të Pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

***Kopja e vendimit u dorëzohet:***

*1. Punëtorit,*

*2. Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,*

*3. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*

*4. Dosjes personale,*

*5. Arkivit.*

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, paragrafi 2, pika 2.4, të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e Floreta Sefsaliut nga Xërxa, Komuna e Rahovecit, me Nr. Protokolli 5698, e datës 10.10.2023, për ndihmë financiare prej 1,000.00€ (një mijë euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes) së trinjakëve.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Flora Morina, më datë 10.10.2023, ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje), pasi e njëjta ka lindur trinjakë në spital.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes së trinjakëve e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijët e porsalindur, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për Floreta Sefsaliun, si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjat e porsalindura (trinjakë).

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Floreta Sefsaliu nga Xërxa,***
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr. 5184 Nr. 31
10.10.23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik me Nr. Prot. 82/2022 të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, rekomandimit të Menaxherit të Projektit dhe Mbikqëyrësit të Drejtëpërdrejtë me Nr. Prot. 5706 të datës 10.10.2023 për ndërprerjen e kontratës me titull: "Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrockave në komunën e Rahovecit" me numër të kontratës 623-18-7960-5-1-1, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanëshme me titull "Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrockave në komunën e Rahovecit"**

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanëshme me titull "Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrockave në komunën e Rahovecit", me numër të kontratës 623-18-7960-5-1-1.

2. Ndërprerja e kontratës me marrëveshje të dyanëshme sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për shkak të ngjarjes së shkaktuar nga forca madhore, që është shkaktuar pas datës kur kontrata ka hyrë në fuqi.

3. Obligohet Zyra e Prokurimit që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Pas zhvillimit të të gjitha procedurave të prokurimit, Komuna e Rahovecit (në vazhdim Autoriteti Kontraktues), ka nënshkruar Kontratë publike kornizë me Grupin e Operatorëve Ekonomik N.N.SH. "CO-ING dhe "HIDRO PROJECT" Sh.p.k me adresë në Prishtinë (në vazhdim Furnizuesi), me titull "Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrockave në komunën e Rahovecit", me numër të kontratës 623-18-7960-5-1-1 me Nr. Prot. 3232 të datës 06.12.2018.

Pas nënshkrimit të kontratës Autoriteti Kontraktues ka kryer punët sipas kushteve të parapara në kontratë.

Mirëpo, pas paraqitjes së Pandemisë COVID-19, situata ka ndryshuar, sepse artikujt të cilat janë objekt i punimeve sipas kësaj kontrate kanë pësuar ndryshime të mëdha në çmimin e furnizimit në treg.

Për këtë arsye, Grupi i Operatorëve Ekonomik N.N.SH. "CO-ING dhe "HIDRO PROJECT" Sh.p.k, ka parashtruar kërkesë përmes postës elektrinike (emailit), tek menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi

i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës me datë 9.10.2023 të cilët janë caktuar me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ, ndërprerjen e kontratës me titull: "Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrockave në komunën e Rahovecit", me numër të kontratës 623-18-7960-5-1-1, me arsyetimin, se çmimet e produkteve nga momenti i nënshkrimit të kontratës në vitin 2018, kanë pësuar rritje të mëdha në vitin 2022, dhe me këtë rast është e pamundur kryerja e punimeve sipas kontratës.

Pas kësaj, Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës, u janë drejtuar Kryetarit të Komunës me kërkesë/rekomandim me Nr. Prot. 5706 të datës 10.10.2023 për ndërprerjen e kontratës me titull "Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrockave në komunën e Rahovecit", me numër të kontratës 623-18-7960-5-1-1, sipas kërkesës së arsyetuar të operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, pas kërkesës së pranuar të Grupit të Operatorëve Ekonomik N.N.SH. "CO-ING dhe "HIDRO PROJECT" Sh.p.k të datës 09.10.2023 si dhe rekomandimit të menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të kontratës për ndërprerjen e kontratës me titull "Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrockave në komunën e Rahovecit", me numër të kontratës 623-18-7960-5-1-1, për shkak të rritjes së vazhdueshme të çmimeve të produkteve bazë për ndërtim në bursa ndërkombëtare poashtu edhe në Republikën e Kosovës, pas paraqitjes së Pandemisë COVID-19, si dhe duke u bazuar në nenin 38 të kësaj kontrate në të është e paraparë "forca madhore" e cila është shkaktuar pas datës kur kontrata ka hyrë në fuqi.

Pas administrimit të të gjitha provave, Kryetari i Komunës ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me Nr. Prot. 3232 të datës 06.12.2018 me titull "Rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrockave në komunën e Rahovecit", me numër të kontratës 623-18-7960-5-1-1.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Zyra e Prokurimit,***
- ***Menaxheri i Projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i menaxherit të projektit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik me Nr. Prot. 82/2022 të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kërkesës dhe rekomandimit të Menaxherit të Projektit me Nr. Prot. 02/3185 të datës 10.10.2023 për ndërprerjen e kontratës me titull: "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit" me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C382, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit"**

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit" me Nr. Identifikues: 623-22-5173-2-1-1/C382, me Nr. Prot.: 2355, e datës 4.7.2022.

2. **Obligohet** Zyra e Prokurimit që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

Gërmia Gashi nga Rahoveci, ka parashtruar kërkesë te menaxheri i Kontratës, me Nr. Prot 5656, të datës 5.10.2023, për shkëputjen e kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit" me Nr. Identifikues: 623-22-5173-2-1-1/C382 dhe me Nr. Prot.: 2355, e datës 4.7.2022, e cila ishte e angazhuar si Konsulente individuale – Zyrtar për pranimin e lëndëve, shkresave dhe dokumenteve të tjera, nga data 4.7.2022.

Pas kësaj, menaxheri i kontratës, me kërkesën me Nr. Prot. 02/3185, të datës 10.10.2023, ka kërkuar dhe njëherit ka rekomanduar Zyrtarin Kryesor Administrativ për ndërprerjen e kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. Identifikues: 623-22-5173-2-1-1/C382 dhe me Nr. Prot.: 2355, e datës 4.7.2022, në të cilën Gërmia Gashi ishte e angazhuar si Konsulente individuale – Zyrtar për pranimin e lëndëve, shkresave dhe dokumenteve të tjera.

Duke u bazuar në nenin 10 të Kushtet e Përgjithshme të Kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit" me Nr. Identifikues: 623-22-5173-2-1-1/C382, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, janë

përmbushur të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kësaj kontrate me kërkesë të Ofruesit të Shërbimeve.

Pas administrimit të të gjitha provave, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me Nr. Prot. 2355, e datës 4.7.2022, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit" me Nr. Identifikues: 623-22-5173-2-1-1/C382.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Gërmia Gashi,***
- ***Zyra e Prokurimit,***
- ***Menaxheri i Projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 Statutit të Komunës Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 597 të datës 16.02.2018 për pagesën e mëditjeve të gjithë anëtarëve të të gjitha komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01, Nr. 341/22, të datës 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
### Për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim, **LEJOHET** pagesa e mëditjeve për anëtarët e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të formuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01, Nr. 341/22, të datës 29.6.2022, si në vijim:

| | |
|---|---|
| **1.1.** Berat Duraku | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro); |
| **1.2.** Albnor Mullabazi | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro); |
| **1.3.** Sinan Kryeziu | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro); |
| **1.4.** Burim Krasniqi | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro); |
| **1.5.** Blerina Hajda | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro). |

2. Të lartpërmendurve në pikën 1 të këtij vendimi u lejohet pagesa e mëditjeve pasi kanë marrë pjesë në takimet e mbajtura për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

3. Të lartpërmendurit kanë të drejtë kompensimi duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01, Nr. 597, të datës 16.2.2018, për pagesën e mëditjeve të gjithë anëtarëve të të gjitha Komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

4. Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi buxhetor Paga dhe Mëditje.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Të lartpërmendurve në pikën 1,***
- ***Njësisë së Personelit,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 Statutit të Komunës Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 597 të datës 16.02.2018 për pagesën e mëditjeve të gjithë anëtarëve të të gjitha komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 340/22 të datës 29.6.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Me këtë vendim, **LEJOHET** pagesa e mëditjeve për anëtarët e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të formuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01, Nr. 340/22, të datës 29.6.2022, si në vijim:

| | |
|---|---|
| **1.1.** Erhan Morina | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro); |
| **1.2.** Besnik Hoti | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro); |
| **1.3.** Feriz Thaqi | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro); |
| **1.4.** Sinan Kryeziu | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro); |
| **1.5.** Vjollca Gurgule | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro). |

2. Të lartpërmendurve në pikën 1 të këtij vendimi, u lejohet pagesa e mëditjeve pasi kanë marrë pjesë në takimet e mbajtura për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

3. Të lartpërmendurit kanë të drejtë kompensimi duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01, Nr. 597, të datës 16.2.2018, për pagesën e mëditjeve të gjithë anëtarëve të të gjitha Komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

4. Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi buxhetor Paga dhe Mëditje.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Të lartpërmendurve në pikën 1,***
- ***Njësisë së Personelit,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 Statutit të Komunës Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01, Nr. 597 të datës 16.2.2018 për pagesën e mëditjeve të gjithë anëtarëve të të gjitha komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01, Nr. 377/22, të datës 23.9.2022, për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Me këtë vendim, **LEJOHET** pagesa e mëditjeve për anëtarët e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të formuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01, Nr. 377/22, të datës 23.9.2022, si në vijim:

| | |
|---|---|
| **1.1.** Afrim Oruqi | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro); |
| **1.2.** Erhan Morina | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro); |
| **1.3.** Feriz Thaqi | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro); |
| **1.4.** Melinda Iska | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro); |
| **1.5.** Blerina Hajda | 1 x 30€ = 30€ (tridhjetë euro). |

2. Të lartpërmendurve në pikën 1 të këtij vendimi, u lejohet pagesa e mëditjeve pasi kanë marrë pjesë në takimet e mbajtura për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

3. Të lartpërmendurit kanë të drejtë kompensimi duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01, Nr. 597, të datës 16.2.2018, për pagesën e mëditjeve të gjithë anëtarëve të të gjitha Komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

4. Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi buxhetor Paga dhe Mëditje.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Të lartpërmendurve në pikën 1,***
- ***Njësisë së Personelit,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008")*, dispozitave të Rregullores MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

**Për caktimin e komisionit për regjistrimimin e aseteve jofinanciare, jokapitale të papërdorura, në Administratë, Shëndetësi dhe Arsim**

1. **Caktohet** komisioni për regjistrimimin e aseteve jofinanciare, jokapitale të papërdorura, në Administratë, Shëndetësi dhe Arsim, në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
   1.1. Asllan Mazreku, kryesues,
   1.2. Admirim Durguti, anëtar,
   1.3. Sylejman Kadiri, anëtar.

2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë regjistrimin e aseteve jofinanciare, jokapitale të papërdorura, në Administratë, Shëndetësi dhe Arsim.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013, për Menaxhimin e Pasurisë jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe legjislacionin aktual në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kërkesës së drejtorit të Drejtorisë për Administratë, me Nr. Prot. 5721, të datës 11.10.2023, kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për inicimin dhe zhvillimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit**

1. **Miratohet** kërkesa e Drejtorisë për Administratë me Nr. Prot. 5721, e datës 11.10.2023, për inicimin dhe zhvillimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratën me titull: "Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira", në shumën prej 10,000.00€ (dhjetë mijë euro).

2. Obligohet Zyra e Prokurimit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e procedurave sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Si pasojë e mosofrimit të shërbimeve, bazuar në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës nga ana e Operatorit Ekonomik, me të cilën Komuna e Rahovecit ka pasur kontratë aktive për shërbime të fotokopjes së lidhur me AQP-në, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, respektivisht Komunës së Rahovecit, AQP-ja ka bërë ndërprerjen e kontratës për këto shërbime.

Andaj, në mungesë të këtij lloji të shërbimeve të domosdoshme në Komunën e Rahovecit, por edhe në institucione të tjera vartëse, përfshirë QKMF-në, QMF-të dhe institucionet arsimore, Komuna e Rahovecit është e obliguar që për aktivitetin e prokurimit "Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira" ta përdorë procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit, për një afat të kufizuar kohor, përkatësisht deri në lidhjen e kontratës së rregullt e që do të udhëhiqet me procedurë të hapur, për të cilën Autoriteti Kontraktues menjëherë do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për fillim e saj, duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 2.1 pika (iii), nenin 48.2 dhe nenin 48.r të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik.

Andaj, me krijimin e këtyre rrethanave, është e domosdoshme që të ndërmerret ky veprim, në mënyrë që Komuna e Rahovecit të mund t'i shfrytëzojë fotokopjet dhe printerët me qira, deri në përfundimin e procedurave të rregullta dhe të hapura të Prokurimit, si dhe nënshkrimit të kontratës së re.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Zyrës së Prokurimit,***
- ***Drejtorisë për Administratë,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

3208 ... 33
12 / 10 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: 'Furnizimi dhe montimi i frigodhomës për deponim të ushqimit për çerdhen e fëmijëve "Tulipanët', me Nr. prokurimi: 623-23-10541-1-3-6 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-063-1-3-6, të datës: 10.10.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Jeton Krasniqi, kryesues,
   **1.2.** Gërmia Gashi, anëtare,
   **1.3.** Egzon Thaqi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin 'Furnizimi dhe montimi i frigodhomës për deponim të ushqimit për çerdhen e fëmijëve "Tulipanët', me Nr. prokurimi: 623-23-10541-1-3-6 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-063-1-3-6 të datës: 10.10.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Rregullimi i rrjetit kryesor dhe sekondar të ujësjellësit në objektin e IAAP "Selajdin Mullaabazi - Mici", me Nr. prokurimi: 623-23-10646-5-3-6 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-066-5-3-6, të datës: 10.10.2023, në këtë përbërje:

    **1.1.** Jetmir Ukaj, kryesues,
    **1.2.** Vjollca Berisha, anëtare,
    **1.3.** Egzon Thaqi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Rregullimi i rrjetit kryesor dhe sekondar të ujësjellësit në objektin e IAAP "Selajdin Mullaabazi - Mici", me Nr. prokurimi: 623-23-10646-5-3-6 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-066-5-3-6, të datës: 10.10.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 75, paragrafi 1 i Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr.08/L-197, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, kryetari i Komunës, merr:

**VENDIM**
**PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

1. **LIRIDON GASHI** nga Sapniqi, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtar për Taksa Komunale, në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, **I PËRFUNDON marrëdhënia e punës në shërbimin civil** nga data 1.11.2023.
2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

**LIRIDON GASHI** nga Sapniqi, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtar për Taksa Komunale, në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Erhan Morina, përmes kërkesës për dorëheqje të datës 6.10.2023, e ka njoftuar Njësinë e Personelit se, Liridon Gashi ka dhënë dorëheqje nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, për shkak se do të migrojë në Gjermani.

Sipas nenit 75, paragrafi 1, i Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon kur nëpunësi civil jep dorëheqje nga detyra.

Prandaj, kryetari i Komunës, pas administrimit të provave dhe të fakteve mbi gjendjen reale, vendos si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi, pala ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

**Me vendim të njoftohen:**
1. Liridon Gashi,
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
3. Dosja personale,
4. Arkivi.

**Smajl Latifi**
Kryetar i Komunës

# Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

***Komuna e Rahovecit***

*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr. 3205 ... 53

Dt. 12.10.23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e **Andora Kollari** nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0043033/23, e dt. 29.09.2023 për ndihmë financiare prej 400.00€ (katerqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *A r s y e t i m*

**Znj.Andora Kollari** nga Rahoveci me datë 29.09.2023 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 24.09.2023 ka lindur djal në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për **znj.Andora Kollari**, si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Znj.Andora Kollari nga Rahoveci,***
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Punët e paparapara për Lot 2 – Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike të Rahovecit - Ritenderim", me numër të kontratës: 623-23-9765-5-2-5/C515, si në vijim:

   1.1. Diellza Çanta, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtare për eficiencë të energjisë, pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **CAKTOHET** menaxhere e Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2.** Afrim Dina, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit te Menaxheri i Kontratës.

3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
   **3.1.** Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
   **3.2.** Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
   **3.3.** Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
   **4.1.** Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës

nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

**4.2.** Menaxheri i kontratës, duhet te lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;

**4.3.** Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblerjen;

**4.4.** Pas pranimit te urdhërblerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;

**4.5.** Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.6.** Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.7.** Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.8.** Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;

**4.9.** Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;

**4.10.** Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;

**4.11.** Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.12.** T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;

**4.13.** Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;

**4.14.** T'i japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe

**4.15.** T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.

5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:

**5.1.** Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe

**5.2.** Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Zyrtar Kryesor Administrativ**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

3707 33
12.10.23

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, paragrafi 2, pika 2.6 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427, të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

1. **MIRATOHET** kërkesa e OJQ "Shoqata e Ish të Burgosurve Politik" dega në Rahovec, me Nr. Protokolli 5689, e datës 9.10.2023 për ndihmë financiare prej 2,000.00€ (dy mijë euro) për mbulimin e shpenzimeve të vizitës së qyteteve historike të Republikës së Shqipërisë.

2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

OJQ "Shoqata e Ish të Burgosurve Politikë", dega në Rahovec, ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të anëtarëve të kësaj shoqate, të cilët janë ish - të burgosur politik në qytetet historike të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të njohjes sa më afër të kulturës dhe të historisë së popullit shqiptar.

Andaj, me qëllim të përkrahjes së kësaj kategorie të shoqërisë, është e domosdoshme ndihma financiare për organizimin e kësaj vizite për anëtarët e kësaj shoqate, e cila ka për qëllim vizitën e qyteteve historike të Republikës së Shqipërisë, si dhe vizitën tek Organizata e Veteranëve të LANÇSH-së në Tiranë.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Vendimi u dërgohet :***

- ***OJQ SHBP-së,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

[stamp: illegible registry stamp] 317 ... 36

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, dispozitave të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, dispozitave të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kontratës me titull "Riparimi i monumenteve kulturore – historike dhe i terreneve sportive - Lot 2" me Nr. të Prokurimit: 623-21-4944-5-2-1/C315, Kërkesës së Menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejte me Nr. Prot. 5765, të datës 17.10.2023, kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontratën me titull "Riparimi i monumenteve kulturore – historike dhe i terreneve sportive - Lot 2"**

1. Me këtë vendim, **lejohet** ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull "Riparimi i monumenteve kulturore – historike dhe i terreneve sportive - Lot 2", me Nr. të Prokurimit: 623-21-4944-5-2-1/C315.

2. Ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga pozicionet e kontratës: TABELA II – 12 - Pozicioni 1.4, 1.9, 1.10, 1.12 dhe 1.13; 9 - Pozicioni 3.2 dhe 3.3; 8 – Pozicioni 3.2 dhe 3.3; 10 – Pozicioni 3.2 dhe 3.3; 7 – Pozicioni 3.2 dhe 3.3 dhe 5 – Pozicioni 3.3, në pozicionet e domosdoshme për realizim: TABELA I – 12 – Pozicioni 1.15 dhe 3.2; 11 – Pozicioni 3.5, 3.7 dhe 4.1; 5 – Pozicioni 2.1, 2.2, 2.5, 2.6, 2.7, 3.4 dhe 4.1, pa implikime financiare shtesë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, menaxheri i Kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi) i kontratës me titull "Riparimi i monumenteve kulturore – historike dhe i terreneve sportive - Lot 2", me Nr. të Prokurimit: 623-21-4944-5-2-1/C315, i ka rekomanduar menaxherit të kontratës ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në këtë kontratë, me qëllim të përfundimit të këtij projekti.

Pas kësaj, menaxheri i Kontratës, përmes mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, ka parashtruar kërkesën me Nr. Prot. 5765, të datës 17.10.2023, me anë të së cilës ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ, ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull "Riparimi i monumenteve kulturore – historike dhe i terreneve sportive - Lot 2", me Nr. të Prokurimit: 623-21-4944-5-2-1/C315 dhe atë nga pozicionet e kontratës: TABELA II – 12 - Pozicioni 1.4, 1.9, 1.10, 1.12

dhe 1.13; 9 - Pozicioni 3.2 dhe 3.3; 8 – Pozicioni 3.2 dhe 3.3; 10 – Pozicioni 3.2 dhe 3.3; 7 – Pozicioni 3.2 dhe 3.3 dhe 5 – Pozicioni 3.3, në pozicionet e domosdoshme për realizim: TABELA I – 12 – Pozicioni 1.15 dhe 3.2; 11 – Pozicioni 3.5, 3.7 dhe 4.1; 5 – Pozicioni 2.1, 2.2, 2.5, 2.6, 2.7, 3.4 dhe 4.1, pa implikime financiare shtesë.

Ky ndërrim (kolaodim) i pozicioneve është bërë me qëllim të përfundimit të projektit, me të cilin është rënë dakord me Operatorin Ekonomik dhe me menaxherin e Kontratës dhe mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë të menaxherit të Kontratës, që të bëhet pa implikime financiare.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, menaxherin e kontratës dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Menaxherit të Kontratës,***
- ***Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë,***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427, të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e Kryesisë së Këshillit të fshatit Nushpal, me Nr. Protokolli 5741, e datës 13.10.2023 për ndihmë financiare prej 1,000.00€ (një mijë euro) për mbulimin e shpenzimeve të rregullimit të korsisë mbi përroskën e fshatit.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit dhe do të derdhen në xhirollogari të anëtarit të Kryesisë së Këshillit të Fshatit Nushpal, Besnik Kastrati, Nr. 2019000154523647, në TEB Bank.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *Arsyetim*

Kryesia e Këshillit të fshatit Nushpal, me ndihmën e banorëve, ka marrë iniciativë për rregullimin e korsisë mbi përroskën e fshatit, për kalim më të lehtë të fëmijëve të cilët vijojnë mësimin në shkollën e fshatit, e të cilët e frekuentojnë çdo ditë këtë pjesë për kalim.

Duke marr parasysh se kalimi në këtë pjesë i fëmijëve dhe banorëve të fshatit është i rrezikshëm, Kryesia e Këshillit të fshatit Nushpal, me ndihmën e banorëve, ka marrë iniciativë për rregullimin e kësaj pjese.

Andaj, duke marrë parasysh rëndësinë e sigurisë së banorëve, e në veçanti sigurinë e fëmijëve të cilët në baza ditore kalojnë në këtë pjesë për të vijuar mësimin në shkollë, është e domosdoshme ndihma financiare për rregullimin e kësaj korsie.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Besnik Kastrati nga fshati Nushpal,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Thirrjes publike për projekt-propozime "Komunat për të Rinjtë", me Nr. Prot. 5664, të datës 5.10.2023, kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të projekt-propozimeve nga projekti "Komunat për të Rinjtë"**

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të projekt-propozimeve të nëngranteve në projektin "Komunat për të Rinjtë", në këtë përbërje:
   1.1. Almedina Jaha, anëtare,
   1.2. Muharem Morina, anëtar,
   1.3. Vjollca Selimi - Gurgule, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të projekt-propozimeve të nëngranteve në projektin "Komunat për të Rinjtë", duke u bazuar në thirrjen publike për projekt-propozime "Komunat për të Rinjtë" të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, me Nr. Prot. 5664, të datës 5.10.2023.

3. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në thirrjen publike për projekt-propozime "Komunat për të Rinjtë" të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, me Nr. Prot. 5664, të datës 5.10.2023.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë dhe ka mandat deri në përfundimin e procedurës së shpalljes së përfituesve.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Sarë Simnica, Koordinatore e Projektit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (*"Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"*), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e Këshillit Organizues**

1. Caktohet Këshilli Organizues për 25-vjetorin e rënies së heronjve të kombit, Xhelal Hajda – Toni dhe Selajdin Mullabazi – Mici me bashkëluftëtarë, në këtë përbërje:
   1.1. Fatmir Iska, kryesues,
   1.2. Saranda Sallteku, anëtare,
   1.3. Afrim Dina, anëtar,
   1.4. Avni Morina, anëtar,
   1.5. Qemajl Krasniqi, anëtar,
   1.6. Dervish Çadraku, anëtar,
   1.7. Muharem Morina, anëtar,
   1.8. Remzije Cana, anëtare,
   1.9. Saranda Rama, anëtare,
   1.10.Feriz Thaqi, anëtar,
   1.11.Mentor Veliu, anëtar.

2. Këshilli Organizues ka për detyrë që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit për 25-vjetorin e rënies së heronjve të kombit, Xhelal Hajda – Toni dhe Selajdin Mullabazi – Mici me bashkëluftëtarë.

3. Organizimi dhe ndarja e përgjegjësive për pjesën operative të aktivitetit i takon kryesuesit të Këshillit Organizues.

4. Obligohet Këshilli Organizues që të hartojë raport të detajuar për kryetarin e Komunës mbi mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit për 25-vjetorin e rënies së heronjve të kombit, Xhelal Hajda – Toni dhe Selajdin Mullabazi – Mici me bashkëluftëtarë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e Këshillit Organizues.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Anëtarët e Këshillit Oganizues, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

# Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr. 3236, 36
19 / 10 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 22, paragrafi 1, pika 1.7, i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e Arbanë Qeriqit, nga Redaksia "Dëshmorët e UÇK-së", me Nr. Protokolli 5810, e datës 19.10.2023, për ndihmë financiare prej 975.00€ (nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë euro) për mbulimin e shpenzimeve dhe blerjen e 60 ekzemplarëve të Monografisë "Feniksët e Lirisë".

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

Redaksia "Dëshmorët e UÇK-së", ka nxjerrë në dritë vëllimet e monografisë "Feniksët e Lirisë", në të cilën përfshihen biografitë e dëshmorëve të UÇK-së, UÇPMB-së dhe të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

Duke marrë parasysh se nga shitja e monografive (librave) sigurohen mjete financiare për nxjerrjen në dritë të numrave vijues, pasi redaksia nuk ka fonde të mjaftueshme për këtë, është e domosdoshme ndihma financiare dhe blerja e 60 ekzemplarëve të monografisë "Feniksët e Lirisë", me qëllim të përkrahjes së kësaj redaksie për nxjerrjen e vëllimeve të reja.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Arbana Qeriqi nga Redaksia "Dëshmorët e UÇK-së",***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

3237 36
23/10/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për qasje në dokumente publike**

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/3227, e datës 17.10.2023 për qasje në dokumente publike nga Organizata Joqeveritare "Iniciativa për Progres - INPO" dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike si në vijim:
   **1.1.** Në aktivitetin e prokurimit me titull: "Mbikëqyrja e investimeve kapitale në Komunën e Rahovecit - Ritenderim" me nr. të prokurimit: 623-23-7605-2-2-1; dhe
   **1.2.** Në aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i lokaleve afariste zejtare në Rahovec", me nr. të prokurimit: 623-22-12234-5-2-1.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Arsyetim***

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/3227, e datës 17.10.2023 për qasje në dokumente publike nga Organizata Joqeveritare "Iniciativa për Progres – INPO", për qasje në dokumente publike.

Pas shqyrtimit të kërkesës, i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, dhe atë:

- Në aktivitetin e prokurimit me titull: "Mbikëqyrja e investimeve kapitale në Komunën e Rahovecit - Ritenderim", me nr. të prokurimit: 623-23-7605-2-2-1, dhe atë: Kërkesën për inicimin e aktivitetit të prokurimit; Deklaratën e nevojave për përcaktimin dhe disponueshmërinë e fondeve dhe zotimin e mjeteve; Procesverbali i hapjes publike; Vendimi për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave; Profesioni dhe pozita e secilit anëtar të komisionit; Deklarata nën betim e anëtarëve të komisionit vlerësues; Raporti i vlerësimit; Kopja e kontratës së bashku me kushtet e veçanta dhe listën e çmimeve; Kopjen e planit të menaxhimit të kontratës dhe Sigurinë e tenderit; dhe

- Në aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i lokaleve afariste zejtare në Rahovec", me nr. të prokurimit: 623-22-12234-5-2-1 dhe atë: Vendimin për caktimin e menaxherit të kontratës; Profesioni i menaxherit të kontratës dhe pozita e tij brenda AK; Plani i menaxhimit të kontratës; Faturat e Operatorit Ekonomik; Pagesat duke përfshirë dokumentet (urdhërpagesën, urdhërblerjen, zotimin e mjeteve); Raportin e menaxherit të kontratës duke përfshirë raportin përfundimtar; Raportin e komisionit mbikëqyrës; Raportin e pranimit teknik dhe Sigurimin e ekzekutimit.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Blerta Gashit, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,***
- ***OJQ "Iniciativa për Progres - INPO", dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr. 3152 Nr. i faqeve 36
Data 20/10/23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Ndërtimi i qendrës rinore dhe kulturore në Rahovec - Ritenderim", me numër të kontratës: 623-23-9402-5-1-1/C518, si në vijim:

   **1.1.** "P.M.N." Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2.** Afrim Dina, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, ndërsa, Albnor Mullabazi, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** ndihmës/asistent i mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit te Menaxheri i Kontratës.

3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
   **3.1.** Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
   **3.2.** Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
   **3.3.** Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
   **4.1.** Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në

Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

**4.2.** Menaxheri i kontratës, duhet te lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;

**4.3.** Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblerjen;

**4.4.** Pas pranimit te urdhërblerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;

**4.5.** Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.6.** Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.7.** Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.8.** Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;

**4.9.** Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;

**4.10.** Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;

**4.11.** Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

**4.12.** T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;

**4.13.** Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;

**4.14.** T'i japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe

**4.15.** T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.

**5.** Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:

**5.1.** Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe

**5.2.** Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.

**6.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 75, paragrafi 1 i Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr.08/L-197, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, kryetari i Komunës, merr:

**VENDIM**
**PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

1. **BUKURIJE RAMADANI** nga Krusha e Madhe, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Asistente Administrative, në Drejtorinë për Administratë, **I PËRFUNDON marrëdhënia e punës në shërbimin civil,** nga data 1.10.2023.
2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

**BUKURIJE RAMADANI** nga Krusha e Madhe, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Asistente Administrative, në Drejtorinë për Administratë,

Drejtori i Drejtorisë për Administratë, Besnik Hoti, përmes kërkesës për dorëheqje të datës 4.10.2023, e ka njoftuar Njësinë e Personelit se, Bukurije Ramadani ka dhënë dorëheqje nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, për shkak se do të migrojë në Gjermani.

Sipas nenit 75, paragrafi 1, i Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon kur nëpunësi civil jep dorëheqje nga detyra.

Prandaj, kryetari i Komunës, pas administrimit të provave dhe të fakteve mbi gjendjen reale, vendos si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi, pala ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

**Me vendim të njoftohen:**
1. Bukurije Ramadani
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
3. Dosja personale,
4. Arkivi.

**Smajl Latifi**
Kryetar i Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

# VENDIM

## Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Mbikëqyrja e investimeve kapitale në Komunën e Rahovecit", me numër të kontratës: 623-23-7605-2-2-1/C502, si në vijim:

   1.1. Diellza Çanta, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtare për eficiencë të energjisë, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **CAKTOHET** menaxhere e Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2.** Albnor Mullabazi, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit te Menaxheri i Kontratës.

3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
   **3.1.** Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
   **3.2.** Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
   **3.3.** Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
   **4.1.** Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës

brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

4.2. Menaxheri i kontratës, duhet te lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;

4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblerjen;

4.4. Pas pranimit te urdhërblerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;

4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;

4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;

4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;

4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

4.12. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;

4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;

4.14. T'i japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe

4.15. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.

5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:

5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe

5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/3025, i datës 13.9.2023.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023")*, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Njësisë së Personelit**

1. Me këtë vendim, Agron Thaqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar i Personelit në Njësinë e Personelit, **caktohet** Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Njësisë së Personelit, në Komunën e Rahovecit, nga data 1.11.2023, deri më datë 1.5.2024.

2. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të Njësisë së Personelit, janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Statutin e Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

3. Të lartpërmendurit sipas pikës 1 të këtij vendimi, do t'i takojë kompensimi i pagës së Udhëheqësit të Njësisë së Personelit.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

Duke marrë parasysh se pozita e Udhëheqësit të Njësisë së Personelit në Komunën e Rahovecit është i lirë (vakant), si dhe duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve dhe të detyrave të cilat dalin nga vendi i punës në Njësinë e Personelit, është i domosdoshëm caktimi i Ushtruesit të Detyrës së Udhëheqësit të Njësisë së Personelit.
Andaj, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Agron Thaqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar i Personelit në Njësinë e Personelit, caktohet Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Njësisë së Personelit në Komunën e Rahovecit, nga data 1.11.2023, deri më datë 1.5.2024.
Andaj, bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Agron Thaqit,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Njësisë së Personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**